



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 02.03.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.02.2023, të parashtruar nga Grupi operatorëve Ekonomik " VB.TOFAJ " SH.P.K. & "PE-VLA-KU" sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i shtratit të Lumit Llukac ", Nr. i prokurimit-632-22-8235-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-086-521, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Aprovohet** si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Grupit Operatorëve Ekonomik " VB.TOFAJ " SH.P.K. & "PE-VLA-KU" sh.p.k., e dt.27.02.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i shtratit të Lumit Llukac ", Nr. i prokurimit- 632-22-8235-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-086-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 22.02.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Anullohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 22.02.2023;
- 3.** Autoriteti Kontraktues, vendos që lëndën ta kthej në ri-vlerësim.
- 4.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

Arsyetim

Grupi operatorëve Ekonomik " VB.TOFAJ " SH.P.K. & "PE-VLA-KU" sh.p.k me dt.27.02.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i shtratit të Lumit Llukac " , Nr. i prokurimit- 632-22-8235-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-086-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 02.03.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është pjesërisht i bazuar dhe Autoriteti kontraktues vendos që lëndën ta kthej në ri-vlerësim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

